



Datë: 25.11.2025

Numër Protokolli: 7573/2025

A.nr.1225/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.323/2024, të datës 11.06.2025, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.1511/2023, të datës 11.12.2023, të parashtruar nga ankuesit M.M, D.S, N.M, N.V, S.V, I.T, D.M, D.T, M.R, R.L, B.R, D.V, D.L, V.D, U.V, I.M, M.K, R.B, Zh.V dhe Z.V, të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat Boban Petković nga Shtërpca, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprobuhet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1511/2023, e datës 11.12.2023, e parashtruar nga ankuesit M.M, D.S, N.M, N.V, S.V, I.T, D.M, D.T, M.R, R.L, B.R, D.V, D.L, V.D, U.V, I.M, M.K, R.B, Zh.V dhe Z.V.

II. Anulohet Vendimi Nr.80/2023, datë 25.10.2023, i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ankuesve t’iu kompensoj çdo të ardhur materiale të humbur (pa paguar) nga dita e zbatimit të Vendimit Nr.80/2023 të datës 25.10.2023 e deri në kthimin e tyre në vendin e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën III të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesit si në preambulë të këtij vendimi (*tutje referuar ankuesi*), më datë 11.12.2023, përmes përfaqësuesit të tyre kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.80/2023 të datës 25.10.2023, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të shkeljes së qenësishme të procedurës, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht dhe jo plotësisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.12.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa, kjo e fundit më datë 22.12.2023, ka përcjell shkresat e bashkëngjitura të lëndës, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7388/2023 të datës 11.12.2023 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 80/2023 të datës 25.10.2023, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Autorizimet për përfaqësim; Ankesën e datës 08.11.2023 e ankuesve e dërguar tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Akt Emërimit e ankuesve; Kopjet e ID-së së ankuesve; Përgjigjen në ankesë e datës 22.12.2023; Vendimin A.nr.1511/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.323/2024, të datës 11.06.2025, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për prova shtesë ë datës 10.07.2025; Përgjigjen e datës 21.07.2025; Vendimin me Nr. 38/2025 të datës 10.03.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Vendimin me Nr. 109/2025 të datës 21.05.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Listat e pagave maj, qershor, prill, mars 2025; Vendimin me Nr. 38.2025 të datës 10.03.2025 për lirimin nga shërbimit civil të ankuesit M.R.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesit janë të punësuar në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si nëpunës të shërbimit civil, rrjedhimisht të njëjtit janë pjesë e kësaj ministri si rezultat i zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 25.01.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 80/2023, me të cilin nëpunësit të angazhuar në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës sipas Marrëveshjes së Brukselit në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nga data 01.10.2023, shkojnë me zero në listën e pagës, deri në zgjidhjen përfundimtare të vijueshmërisë së rregullt të tyre në punës, mbi bazën e arsytimit: *Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të sistemuar dhe rregulluar vijueshmërinë e nëpunësve të angazhuar në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës sipas Marrëveshjes së Brukselit, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur të zgjedh këtë çështje. Sistemimi në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës nuk ka qenë i mundur për këtë pasi objektet qeveritare, kanë qenë në mandat të ish-Ministrisë së Administratës Publike dhe tani janë në mandat të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka bërë përpjekje që vijueshmëria e tyre të rregullohet duke i transferuar në Prishtinë, që detyrat e tyre të kryhen në objektin qendror të MKRS-së por për arsye të pamundësisë si dhe rrethanave të tjera ky transferim në këtë fazë është i pamundur.*

Ankuesit kundër këtij vendimi kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se vendimi i kontestuar me ankesë nuk pasqyron shkaqet pse është ndërprere marrëdhënia e punës ngase për ankuesit nuk është iniciuar asnjë procedurë disiplinime dhe të gjitha punët janë kryer deri në marrjen e vendimit përfundimtar; Vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk mbështetet në asnjë normë të ndonjë ligji apo akti nënligjor dhe se me këtë vendim palëve ankuese i'u është ndërprerë marrëdhënien e punës në mënyrë arbitrar. Kërkojnë

që ankesa të aprovohet, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të bëjë kompensimin e pagave të papaguara nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi deri në kthimin në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së ankuesve, më datë 25.01.2024 ka nxjerr Vendimin A.nr.1511/2023, me të cilin ka hedhë poshtë si të jashtë afatshme ankesën e datës 01.12.2023 të ankuesve. Ankuesit kundër këtij vendimi kanë iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente, gjegjësisht Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa, kjo e fundit më Aktgjykimin A.nr.323/2024 të datës 11.06.2025, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ka anuluar Vendimin A.nr.1511/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh pikëpamjet e dhëna nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më Aktgjykimin A.nr.323/2024, ka rishqyrtuar ankesën e datës 01.12.2023 të ankuesve dhe pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka trajtuar çështjen ankimore në kuptim meritore dhe si rrjedhojë ka vlerësuar bazën ligjore në fuqi në atë kohë gjegjësisht Ligjin Nr.06/l-114 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenin 32 më të cilin është përcaktuar: *1. Marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil (në vijim: marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil) është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative. 2. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar). 3. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji....”*

-Nenin 59 paragrafi 1, ku përcaktohej: *1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon, si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirimin nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj.*

Në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka analizuar Vendimin Nr.80/2023 të datës 25.10.2023, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së dhe si rrjedhojë konstaton së akti i kontestuar është i paqartë dhe kundërthënës, pasi që nga pjesa arsyetuese e tij nuk mund të kuptohet së a kemi të bëjmë më ndërprerje të marrëdhënies së punës apo të pagës dhe së mbi cilën bazë ligjore është nxjerr ky akt. Rrjedhimisht, siç u tha më sipër, akti i goditur më ankesë është nxjerrë vetme mbi bazën se përkundur përpjekjeve të vazhdueshëm për të sistemuar dhe rregulluar vijueshmërinë e punës së ankuesit ka qenë e pamundur të zgjidhet kjo çështje.

Në fakt, nisur nga sqarimet si në arsyetimin e vendimit të kontestuar, rrjedhë së largimi i ankuesve nga lista e pagave nuk është si pasojë e veprimeve të ankuesit, pra mos vijueshmërisë së tyre në punë, por si pasojë e pamundësisë së institucionit që ankuesit ti sistemoj në vende përkatëse të punës dhe të rregulloj vijueshmërinë në punë. Kështu që, marrë për bazë detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga Marrëveshja e Brukselit (2013) si dhe në mbështetje të parimeve themelore në procedurë administrative (parimi i ligjshmërisë, parimi proporcionalitetit, parimi i barazisë dhe mos diskriminimit, dhe parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme), organi i punësimit, në këtë rast Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duhet të garantoj sistemim të ankuesve në pajtim me kualifikimet e tyre profesionale si dhe kushte të përshtatshme për ushtrim të rregullt dhe efikas të punës.

Kolegji për vendimmarrje të drejtë lidhur me këtë çështje, më datë 10.07.2025 i është drejtuar më kërkesë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për sqarim se: *..ankuesit janë kthyer në vendet e tyre të punës dhe nëse janë paguar për pagat në dita e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 80/2023 të datës 25.10.2023, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe*

Sportit. Ndërsa, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit/Njësia e Personelit në përgjigje të kërkesës së më datë 21.07.2025 ka përcjell sqarimin si vijon: Ankuesit janë kthyer në vendin e punës sipas akt emërimeve dhe kontratave të punës sipas vendimeve të datës 10.03.2025 më nr. të protokollit 1187/205 dhe 25.05.2025 më nr.protokolli 2656/25, pas plotësimit të kushteve për vijueshmëri të rregullt në punë; Pagat janë paguar bazuar në vendimet nga datat: 10.03.2025 më nr. të protokollit 1187/205 dhe 25.05.2025 më nr.protokolli 2656/25, ne mënyrë retroaktive nuk janë paguar.

Andaj, bazuar në gjendjen e fakteve si me lartë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së akti i kontestuar është nxjerrë më kundërshtim më ligjin material dhe së i njëjti nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm, të qartë dhe rrjedhimisht kundërthënës, kështu që, i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Rrjedhimisht, mbi rrethanën së ankuesit janë kthyer në punë, Kolegji aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi Vendimin Nr.80/2023 të datës 25.10.2023, të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe obligoj Sekretarin e Përgjithshëm që ankuesve t'iu kompensoj çdo të ardhur materiale të humbur nga dita e zbatimit të Vendimit Nr.80/2023 të datës 25.10.2023 e deri në kthimin e tyre.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1225/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat Boban Petkoviq;
- Z. Rexhep Gashi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.